

DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

PYETJE- PËRGJIGJE TË SHPESHTA PËR PROJEKTET PKKZH

Pyetje 1: Çfarë janë Programet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit (PKKZH)?

Përgjigje: Programet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit janë paraqitje sintetike e aktiviteteve sistematike kërkimore dhe zhvillimore, që ndërmerren për të arritur objektiva të caktuar në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik me rendësi për përparimin e vendit. Programet Kombëtare zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe mbështesin në aspektin kërkimor dhe zhvillimor Programin e Qeverisë për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit.

Pyetje 2: Cili është qëllimi i PKKZH?

Përgjigje: Qëllimi i programit është të mbështesë realizimin e aktiviteteve të kërkimit shkencor dhe inovacionit në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) dhe institucione kërkimore shkencore. Mbështetja ofrohet për projekte që përputhen me fushat prioritare kombëtare dhe zhvillimet rajonale dhe europiane të kërkimit shkencor si dhe për projekte të mbështetura në marrëveshje bashkëpunimi të IAL-ve dhe institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit ndërmjet tyre, ndërmjet IAL-ve dhe sektorit të biznesit si dhe projekte që nxisin inovacionin;

Pyetje 3: Kush ka të drejtë të aplikojë në thirrjet për projekt-propozime PKKZH pranë AKKSHI?

Përgjigje: Kanë të drejtë të aplikojnë për financim të projekteve në kuadër të PKKZH, Institucionet e Arsimit të Lartë të përcaktuara si të tilla në pikën 4, të Nenit 4, të Ligjit Nr. 80/2015, si dhe dhe institucionet publike e jopublike, që kanë për objekt të veprimtarisë për kërkimin shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane.

Pyetje 4: Ku e marrim informacionin për thirrjet e hapura PKKZH?

Përgjigje: Thirrja për aplikim për projekte PKKZH publikohet në faqen zyrtare të AKKSHI <http://nasri.gov.al/> dhe në faqen zyrtare të MASR <https://arsimi.gov.al>.

Pyetje 5: Cili është dokumentacioni i kërkuar për aplikim?

Përgjigje: Informacioni lidhur me dokumentacionin e kërkuar për aplikim për projekte PKKZH gjendet në Udhëzuesin përkatës i cili është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të AKKSHI në linkun: <http://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare-2/> . Çdo aplikim dorëzohet nëpërmjet protokollit në AKKSHI i shoqëruar me shkresë zyrtare të institucionit që aplikon (Agjencia ekzekutuese) për projektin. Projekt-propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Formës së Aplikimit të Projektit për Kërkim e Zhvillim (Aneks 1) dhe Formës së Propozimit Financiar (Aneks 2). Sqarimet për mënyrën e plotësimit të Dokumentit të Projektit për Kërkim dhe Zhvillim dhe të Formës së Propozimit Financiar gjenden në (Aneks 2/1).

Pyetje 6: Cilat janë afatet e aplikimit dhe frekuencat e thirrjeve?

Përgjigje: Hapja e thirrjeve PKKZH bëhet me vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI, mbi bazën e buxhetit të akorduar për këtë qëllim. Kohëzgjatja e zbatimit të projekteve PKKZH është maksimalisht 2 vjet dhe minimalisht 1 vit kalendarik.

Pyetje 7: Sa është masa e financimit vjetor për çdo projekt PKKZH?

Përgjigje: Projektet PKKZH financohen nga buxheti i shtetit. Masa e financimit për çdo projekt caktohet mbi bazën e buxhetit të akorduar, miratuar me vendim të bordit të administrimit të AKKSHI-së.

Pyetje 8: Ku t'i kërkojmë prioritetet strategjike sipas fushave prioritare?

Përgjigje: Dokumentat orientuese janë Strategjitë Kombëtare Sektoriale që hartohen nga ministritë e linjës.

Pyetje 9: Kush firmos në dokumentat e aplikimit?

Përgjigje: Aplikimi përcillet nga institucioni me shkresë përcjellëse të titullarit. Forma e aplikimit (Aneks 1) firmoset nga rektori dhe drejtuesi i projektit. Forma e buxhetit (Aneks 2) firmoset nga rektori, administratori i institucionit, drejtuesi i zyrës së financës të institucionit dhe drejtuesi i projektit.

Pyetje 10: Si bëhen pagesat e personelit dhe të udhëtimeve?

Përgjigje: Pagesat e personelit dhe të udhëtimeve bëhen komform legjislacionit shqiptar në fuqi. Projektet PKKZH nuk parashikojnë mobilitet të huaj.

Pyetje 11: Cilat janë kostot e lejuara?

Përgjigje: Kostot që lidhen me kërkimin, me mobilitetin dhe publikimin e rezultateve të kërkimit: Pagat e personelit, udhëtimet dhe dietat (bileta transport publik, fatura hoteli, dieta ditore në bazë të VKM-së për udhëtimet brenda vendit për punonjësit e administratës shtetërore), seminare dhe konferenca, kostot e publikimit të rezultateve të kërkimit dhe të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit dhe shpenzimet administrative.

Pyetje 12: A ka ndonjë raport ndërmjet zërave të shpenzimeve (1. pagat e personeli, 2. Udhëtime dhe dieta, 3. Seminare/Konferenca, 4. Publikime dhe 5. Shpenzime administrative)?

Përgjigje: AKKSHI nuk ka përcaktuar një raport ndërmjet zërave të shpenzimeve por, referuar praktikës europiane të projekteve dhe logjikës së kërkimit shkencor, pjesën më të madhe të shpenzimeve duhet ta zënë shpenzimet që lidhen direkt me kërkimin (paga, seminare, publikime, etj). Pra raporti kërkim/udhëtime dhe dieta duhet të jetë në favor të kërkimit. Në plotësimin e formatit financiar çdo zë duhet të jetë i përcaktuar mirë dhe qartë dhe duhet të përshkruhet në mënyrë të detajuar në kolonën "Përshkrim i detajuar".

Pyetje 13: A ka ndonjë kufi në lidhje me zerin e pagës së personelit/personit të përfshirë (deri në sa rroga mujore lejohet shpërblimi)?

Përgjigje: Shpërblimi nuk është me rroga mujore, por me angazhim me ditë - pune në projekt. Pra, pagesa është për ditë - pune dhe llogaritjet duhen bërë me ditë - pune.

Pagesa për ditë - pune për çdo anëtar grupi të projektit, është e barabartë me pagesën që ju keni në institucionin tuaj punëdhënës, sipas përcaktimeve të kontratës së punës së secilit. Edhe në këtë rast kolona “përshkrim i detajuar” duhet plotësuar me saktësi.

Pyetje 14: Te zërat e shpenzimeve cili është dallimi ndërmjet pikës 2.3 (Transport brenda territorit) dhe 2.4 (Transport brenda territorit, shpenzime karburanti)?

Përgjigje: Zëri 2.3 është për shpenzime brenda territorit duke përdorur transport publik (paraqiten biletat e transportit publik si dokumenta mbështetës), ndërsa 2.4 bëhet fjalë për rastet kur përdoren mjetet jo-publike dhe natyrisht çdo lëvizje duhet e reflektuar me fatura dhe me km. Shikoni sqarimet në fund të tabelës te forma e buxhetit.

Pyetje 15: Cilat kosto janë të palejueshme?

Përgjigje: Kostot për pajisje dhe aparatura që lidhen me kërkimin. Aplikantët duhet të përdorin aparaturat dhe materialet ekzistuese nëpër institucionet aplikuese të të dyja palëve. Gjithashtu edhe kostot për mobilitet te huaj.

Pyetje 16: A mund të kërkoj financim shtesë nga palë të treta?

Po, të gjitha format e ligjshme të financimit janë të pranueshme për pjesën e kostove të cilat nuk mbulohen nga AKKSHI.

Pyetje 17: Në rastet kur aplikimi bëhet nga një IAL dhe përfshihet një Institucion publik a është e nevojshme ndonjë dokument shtesë?

Përgjigje:

a) marrëveshje bashkëpunimi kuadër midis dy institucioneve, nëse ekziston;

b) nëse nuk ka marrëveshje bashkëpunimi kuadër, atëherë paraqitet marrëveshje/kontratë bashkëpunimi/shkresë e përbashkët, ku të specifikohet bashkëpunimi për projektin konkret.

c) nëse parashikohet kontribut financiar i palës tjetër për projektin konkret, kjo duhet të pasqyrohet në marrëveshjen/kontratën/shkresën midis 2 institucioneve, të firmosur nga titullarët përkatës.

Pyetje 18: A mund të kërkoj rialokim të fondeve në zera të ndryshëm të planit të financimit?

Përgjigje: Kërkesa për rialokim bëhet nga aplikanti me shkrim dhe po kështu, aprovimi ose refuzimi jepet nga AKKSHI me shkrim. Lejohen ndryshimet vetëm brenda zërave deri në 10% të shumës së miratuar.

Pyetje 19: A mundet që projekt-propozimi t'i përkasë më shumë se një fushe prioritare?

Përgjigje: Projekt-propozimi duhet të fokusohet vetëm në një fushë prioritare sepse komisionet e vlerësimit janë të ndarë sipas fushave.

Pyetje 20: Kush e kryen vlerësimin?

Përgjigje: Vlerësimi kryhet nga grupe ekspertësh, të cilët përzgjidhen nga një konkurim i hapur bazuar në kritere të përcaktuara në thirrjen përkatëse. Lista e Komisioneve të Ekspertëve të Vlerësimit në bazë të fushave prioritare miratohet nga Bordi i Administrimit i AKKSHI-së. Çdo komision përbëhet nga 5 ekspertë.

Pyetje 21: Si vendosen fituesit?

Përgjigje: Fituesit vendosen në bazë të vlerësimit të dhënë nga Komisionet e Ekspertëve të Vlerësimit. Bordi i Administrimit i AKKSHI-se miraton listen e fituesve dhe shumën përkatëse të akorduar për çdo projekt.

Pyetje 22: Kur fillon financimi?

Përgjigje: Pas marrjes së miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI dhe nënshkrimit të kontratave me fituesit.

Pyetje 23: A është detyrim publikimi i rezultateve të projekteve?

Përgjigje: Po, publikimi i rezultateve është detyrim ligjor. Rrit transparencën lidhur me projektet dhe ndalon duplikimin e kërkimeve.